

# RELACION

## PËR PROJEKTLIGJIN

### “PËR KINEMATOGRAFINË DHE AUDIOVIZUALIN”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “*Për kinematografinë dhe audiovizualin*” përbën një transformim substancial dhe gjithëpërfshirës të arkitekturës normative që rregullon industrinë filmike dhe krijimtarinë audiovizuale në Republikën e Shqipërisë. Në një kontekst global ku dinamika teknologjike, ekonomike dhe kulturore ka rimodeluar në mënyrë të vazhdueshme mënyrat e prodhimit, financimit dhe shpërndarjes së përmbajtjeve, nevoja për një kuadër ligjor modern dhe funksional shfaqet si një kërkesë e domosdoshme strategjike, kjo pasi se ligji aktual nr. 8096, datë 21.03.1996 “*Për kinematografinë*”, i miratuar në vitin 1996 dhe i ndryshuar pjesërisht në vitin 2005, është konceptuar në një kontekst krejtësisht të ndryshëm. Ky ligj, ndonëse ka shërbyer si bazë për zhvillimin e kinematografisë shqiptare në periudhën pas tranzicionit, nuk parashikon instrumente të përshtatshme për të adresuar zhvillimet e reja në fushën e prodhimit audiovizual, sidomos në raport me platformat digjitale, bashkëprodhimet ndërkombëtare dhe mekanizmat bashkëkohorë të financimit.

Në këtë kuadër, projektligji i ri synon të krijojë një bazë ligjore moderne dhe funksionale, e cila jo vetëm rregullon veprimtarinë ekzistuese, por edhe orienton zhvillimin e ardhshëm të sektorit në përputhje me standardet europiane dhe praktikatat ndërkombëtare më të mira. Projektligji propozon një qasje të re konceptuale dhe institucionale, duke kaluar nga një model tradicional mbështetjeje për prodhimin filmik drejt një vizioni të integruar që përfshin të gjithë spektrin e krijimtarisë audiovizuale, përfshirë format televizive, prodhimet për platformat digjitale, veprat eksperimentale, videolojërat dhe formatet hibride,, duke forcuar mekanizmat e qeverisjes së mirë dhe orientim të sektorit drejt standardeve europiane të rregullimit, transparencës dhe konkurrueshmërisë

Kjo reformë përbën shtyllën themelore të konceptit të ri ligjor. Projektligji tejkalon kufijtë tradicionalë të rregullimit, i cili më parë kufizohej në prodhimin

filmik, duke përfshirë tani të gjithë spektrin e krijimtarisë audiovizuale: prodhimet episodike dhe televizive, përmbajtjet për platformat digjitale dhe OTT, veprat interaktive, videolojërat, formatet hibride dhe veprat e reja eksperimentale. Ky zgjerim garanton një rregullim të integruar dhe të harmonizuar me qasjet bashkëkohore europiane.

Tjetër risi e këtij projektligji është e natyrës ekonomike dhe zhvillimore. Për herë të parë, projektligji krijon një arkitekturë moderne të instrumenteve fiskale, në funksion të nxitjes së investimeve në sektor si skemat e rimbursimit të shpenzimeve të prodhimit (cash rebate). Ky mekanizëm synon të stimulojë investimet private në prodhimet filmike dhe audiovizuale. Ky mekanizëm përbën një nga instrumentet më të përdorura në vendet europiane dhe gjatë zbatimit ka treguar efektivitet në rritjen e volumit të prodhimit dhe në tërheqjen e investimeve të huaja. Mungesa e këtij instrumenti në ligjin aktual ka qenë një nga faktorët që ka kufizuar zhvillimin e këtij sektori në Shqipëri.

Projektligji vendos një arkitekturë moderne të mbështetjes financiare përmes instrumenteve selektive (thirrje publike konkurruese) dhe automatike. Në këtë kuadër, parashikohet skema e rimbursimit të shpenzimeve (cash rebate), me normë rimbursimi 35% të shpenzimeve të kualifikuara të kryera në territorin e Republikës së Shqipërisë, me auditim të detyrueshëm dhe procedura të standardizuara certifikimi. Financimi i skemës realizohet përmes Fondit të Cash Rebate, si zë i dedikuar buxhetor.

Nëpërmjet integritit të këtyre mekanizmave në këtë projektligj, Shqipëria propozohet të pozicionohet si një destinacion konkurrues për prodhimet audiovizuale ndërkombëtare, duke stimuluar përthithjen e investimeve private dhe duke zhvilluar më tej zinxhirin ekonomik që mbështet industrinë.

Në vijim të reformave strategjike, projektligji parashikon transformimin institucional të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë (QKK) në Agjencinë Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA), një strukturë moderne dhe e zgjeruar, e konceptuar si organi qendror publik i politikave, financimit, zhvillimit dhe mbikëqyrjes së industrisë audiovizuale.

Ndryshe nga modeli aktual, ku QKK ushtron kryesisht funksione financuese dhe koordinuese, AKKA konceptohet si një institucion publik me kompetenca të zgjeruar për hartimin dhe zbatimin e politikave, administrimin e fondeve publike,

mbështetjen financiare, certifikimin e shpenzimeve të kualifikuara dhe koordinimin e mekanizmave të zhvillimit të sektorit.

Përmes funksioneve të saj të reja, të cilat përfshijnë hartimin dhe zbatimin e politikave zhvillimore, mbështetjen e prodhimit dhe promovimit, si dhe përfaqësimin ndërkombëtar të industrisë shqiptare kinematografike dhe audiovizuale, administrimin e skemës së rimbursimit të shpenzimeve (cash rebate), ky institucion synon të shndërrohet në një instrument efektiv të politikës publike në fushën e industrive kreative.

Risia me ndikim të drejtpërdrejtë operacional dhe promovues është krijimi i Komisionit Shqiptar të Filmit (Albanian Film Commission), i cili do të funksionojë brenda ekosistemit të ri të AKKA, si pikë unike e kontaktit për prodhuesit vendas dhe ndërkombëtarë, si strukturë e lehtësimit administrativ dhe logjistik të xhirimeve, për promovimin e Shqipërisë si destinacion filmik.

Projektligji gjithashtu vendos një qasje të re në drejtim të planifikimit dhe zhvillimit strategjik të sektorit, përmes parashikimit të Programit Kombëtar për Zhvillimin e Krijimtarisë Kinematografike dhe Audiovizuale, si dokument strategjik 4-vjeçar që përcakton objektivat strategjike, prioritetet dhe kategoritë e financimit, kuadrin financiar orientues, treguesit e performancës dhe mekanizmat e vlerësimit. Programi miratohet nga Këshilli Drejtues, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, dhe i nënshtrohet konsultimit publik. Ky dokument strategjik synon të përcaktojë prioritetet, objektivat zhvillimore dhe drejtimet e politikave në një horizont afatmesëm dhe afatgjatë, duke garantuar koherencë, vazhdimësi dhe parashikueshmëri në ndërhyrjet publike. Përmes tij, sektori fiton një kornizë të qartë orientuese, e cila mundëson hartimin e politikave të integruara, të bazuara në evidencë dhe të harmonizuara me objektivat kombëtare dhe ato europiane. Një mekanizëm i tillë mungon plotësisht në kuadrin aktual ligjor, i cili funksionon mbi vendimmarrje të fragmentarizuar, shpesh afatshkurtra dhe të varura nga ciklet institucionale, duke kufizuar koherencën strategjike dhe efektivitetin e politikave të ndërmarra.

Nga pikëpamja e qeverisjes institucionale, projektligji sjell një ndryshim thelbësor duke kaluar nga një model i centralizuar në një organ të vetëm drejtues, siç është rasti i Kryetarit të QKK-së, në një strukturë kolegjiale, transparente dhe të balancuar. Projektligji vendos një model të ri qeverisjeje institucionale përmes

Këshillit Drejtues, si organ kolegjal vendimmarrës dhe mbikëqyrës, dhe Drejtorit të Përgjithshëm, si autoritet ekzekutiv. Ky model synon të rrisë profesionalizmin, transparencën dhe balancimin ndërmjet interesit publik dhe dimensionit profesional të sektorit.

Kjo qasje e reformuar nxit përfshirjen më të gjerë të aktorëve të industrisë në proceset vendimmarrëse dhe kontribuon në krijimin e një balancimi të qëndrueshëm ndërmjet interesit publik dhe dimensionit profesional të sektorit. Përmes këtij modeli, garantohen transparencë më e lartë, llogaridhënie më e fortë dhe një proces politikëbërjeje më gjithëpërfshirës, i përputhur me praktikën më të mira të qeverisjes së institucioneve homologe europiane.

Një tjetër risi e projektligjit konsiston në riorganizimin institucional dhe funksional të shoqërisë ekzistuese “Albafilm” sh.a., aktualisht në pronësi të ministrisë përgjegjëse për kulturën, përmes transferimit të pronësisë 100% të aksioneve të saj tek Agjencia Kombëtare e Kinematografisë dhe Audiovizualit. Albafilm sh.a. rikonceptohet si një aktor kyç në zhvillimin e sektorit filmik dhe audiovizual, duke kaluar nga një strukturë tradicionale menaxhuese në një qendër të integruar prodhimi dhe shërbimesh (production hub). Në këtë funksion të ri, shoqëria synon të ofrojë kapacitete infrastrukturore, teknike dhe logjistike për mbështetjen e prodhimeve vendase dhe ndërkombëtare, duke kontribuar në rritjen e cilësisë dhe konkurrueshmërisë së sektorit. Në të njëjtën kohë, Albafilm sh.a. luan një rol të rëndësishëm në aktivizimin dhe menaxhimin e aseteve ekzistuese filmike, si dhe në krijimin e partneriteteve me sektorin privat dhe institucionet publike. Nëpërmjet këtij organizimi synohet forcimi i rolit të AKKA-së me kompetenca të zgjeruara, duke e konceptuar atë si strukturën qendrore “one stop shop” për industrinë kinematografike dhe audiovizuale në Republikën e Shqipërisë. Në këtë kuadër, AKKA do të ushtrojë jo vetëm funksione mbështetëse dhe rregullatore, por edhe kompetenca të lidhura me koordinimin e infrastrukturës kinematografike dhe audiovizuale, ofrimin e shërbimeve të integruara për produksione vendase dhe ndërkombëtare, si dhe promovimin e Shqipërisë si destinacion konkurrues për investime audiovizuale. Kjo qasje synon të rrisë efikasitetin institucional, të lehtësojë procedurat për sektorin kinematografik dhe audiovizual dhe të krijojë një mekanizëm të centralizuar dhe funksional në mbështetje të zhvillimit të industrisë kreative në vend.

Ky ripozicionim e vendos atë në një marrëdhënie funksionale dhe plotësuese me AKKA-n dhe Komisionin Shqiptar të Filmit, duke forcuar zinxhirin e vlerës së industrisë audiovizuale dhe duke mbështetur zhvillimin e një ekosistemi të qëndrueshëm dhe të integruar në përputhje me praktikrat më të mira evropiane.

Në këtë arkitekturë të re institucionale, Arkivi Qendror Shtetëror i Filmit (AQSHF) integrohet në mënyrë më funksionale brenda ekosistemit të sektorit, duke forcuar rolin e tij në ruajtjen, digjitalizimin dhe aksesin ndaj trashëgimisë filmike, si dhe në mbështetjen e edukimit dhe kërkimit. Koordinimi ndërinstytucional ndërmjet AKKA-s, Albafilm sh.a. dhe AQSHF-së synon të krijojë një sistem të ndërlidhur, ku funksionet rregullatore, promovuese, prodhuese dhe arkivore plotësojnë njëra-tjetrën. Kjo qasje e integruar rrit efikasitetin institucional, shmang mbivendosjet dhe mundëson një zhvillim më të qëndrueshëm dhe konkurrues të sektorit filmik dhe audiovizual në përputhje me praktikrat evropiane.

Një element tjetër i rëndësishëm i projektligjit është krijimi i Regjistratit Kombëtar të Sektorit Kinematografik dhe Audiovizual, i cili përbën një instrument themelor për formalizimin, monitorimin dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit formalizimi dhe strukturimi i tregut filmik dhe audiovizual për veprat dhe subjektet që ushtrojnë veprimtari në këto fusha. Ky regjistër parashikohet si një platformë e integruar, ku do të regjistrohen të gjitha subjektet që operojnë në fushën kinematografike dhe audiovizuale, përfshirë shtëpitë kinematografike, prodhuesit, distributorët, operatorët e shfaqjes, profesionistët dhe ofruesit e shërbimeve të lidhura. Regjistri do të administrohet nga AKKA, e cila do të sigurojë mirëmbajtjen, përditësimin dhe aksesin e kontrolluar në të dhëna, duke garantuar transparencë, gjurmueshmëri dhe mbështetje për politikëbërje të bazuar në evidencë. Ky mekanizëm është i domosdoshëm për të garantuar transparencë, për të krijuar një bazë të besueshme të të dhënave dhe për të mbështetur hartimin e politikave publike të bazuara në evidencë. Në të njëjtën kohë, ai do të shërbejë si një mjet kyç për koordinimin institucional, zhvillimin e tregut dhe rritjen e konkurrueshmërisë së sektorit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Regjistrat përbëjnë një instrument modern të qeverisjes së sektorit, duke mundësuar monitorim të qëndrueshëm, analizë të tregut dhe vlerësim të impaktit të masave mbështetëse. Në ligjin aktual, një sistem i tillë është i fragmentarizuar dhe nuk i përgjigjet kërkesave të një industrie në rritje të vazhdueshme.

Projektligji identifikon gjithashtu rolin e "shtëpisë kinematografike" si subjekt kyç i industrisë, përgjegjës për marrëdhëniet ligjore, administrative dhe financiare, duke e vendosur atë si palë themelore në aplikimin për mbështetje financiare dhe në zbatimin e instrumenteve mbështetëse.

Në vijim të këtij dimensionit rregullator, projektligji gjithashtu i kushton rëndësi të veçantë bashkëprodhimeve ndërkombëtare, të cilat konsiderohen një instrument strategjik për integrimin e industrisë shqiptare në tregun global kinematografik dhe audiovizual. Përmes krijimit të kushteve të favorshme për partneritet me prodhues dhe institucione të huaja, synohet jo vetëm rritja e cilësisë artistike dhe teknike të prodhimeve, por edhe zgjerimi i por edhe zgjerimi i aksesit të tyre në tregje ndërkombëtare. Bashkëprodhimet përfaqësojnë një mjet të domosdoshëm për shkëmbim ekspertize, rritje kapacitetesh profesionale dhe përfshirje në zinxhirët ndërkombëtarë të shpërndarjes, duke kontribuar kështu në afirmimin dhe diversifikimin e produktit audiovizual shqiptar.

Projektligji gjithashtu ka parashikuar mekanizma monitorimi dhe kontrolli. Monitorimi i skemave të mbështetjes financiare, si ato selektive ashtu edhe ato automatike, përbën një element thelbësor për garantimin e transparencës, efektivitetit dhe përdorimit të drejtë të fondeve publike. Në këtë kuadër, AKKA, në bashkëpunim me Komisionin Shqiptar të Filmit (Albanian Film Commission), ushtron funksione të koordinuara për ndjekjen e zbatimit të këtyre skemave, duke përfshirë verifikimin e përmbushjes së kritereve ligjore dhe kontraktuale. Kontrolli tatimor dhe administrativ siguron përputhshmërinë me legjislacionin në fuqi dhe shmangien e abuzimeve, ndërsa auditimi i shpenzimeve të rimbursuara realizohet nga auditues privatë të licencuar, në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat ligjore. Kjo qasje e shumëfishtë e kontrollit kontribuon në forcimin e besueshmërisë së skemave mbështetëse dhe në rritjen e integritetit të gjithë sistemit financiar të sektorit audiovizual.

Në një perspektivë krahasuese, projektligji reflekton orientimin drejt modeleve të konsoliduara europiane, veçanërisht atyre të Italisë dhe Francës, ku institucionet publike të sektorit audiovizual ushtrojnë një rol proaktiv në mbështetjen financiare, promovimin dhe rregullimin e industrisë. Në këto juridiksione, instrumentet e avancuara financiare dhe fiskale, si incentivat fiskale, fondet e dedikuara për zhvillimin e krijimtarisë audiovizuale dhe skemat e strukturuar të mbështetjes për bashkëprodhimet, përbëjnë elementë thelbësorë të politikave

shtetërore, duke siguruar stabilitet, konkurrueshmëri dhe zhvillimin e qëndrueshëm të industrisë audiovizuale.

Në aspektin e bashkëpunimit ndërinstitucional, projektligji ripozicionon Albafilm sh.a. si shoqëri aksionare me kapital shtetëror që ushtron veprimtari në fushën e prodhimit dhe ofrimit të shërbimeve për industrinë audiovizuale dhe zhvillimin e infrastrukturës së filmit, si një ofrues i integruar shërbimesh (production hub), në koordinim me institucionet e ekosistemit. Po ashtu, parashikon bashkëpunimin me Arkivin Qendror Shtetëror të Filmit dhe koordinimin me Autoritetin e Mediave Audiovizuale në çështje të mbrojtjes së të miturve dhe klasifikimit sipas moshës.

Efektet e pritshme të projektligjit lidhen me rritjen e volumit të prodhimeve, tërheqjen e investimeve të huaja, krijimin e vendeve të reja të punës në sektorët mbështetës, formalizimin e tregut dhe rritjen e ekspozimit kulturor e promovimit të territorit, përfshirë efektet pozitive në turizëm (film-induced tourism).

Adoptimi i këtyre mekanizmave në projektligjin shqiptar krijon një kornizë të harmonizuar me praktikat më të mira të Bashkimit Europian, duke garantuar një ekosistem të parashikueshëm, të formalizuar dhe të aftë të gjenerojë rritje të qëndrueshme në industrinë filmike dhe audiovizuale, si në dimensionin kulturor, ashtu edhe në atë ekonomik.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektligji “Për kinematografinë dhe audiovizualin” është në përputhje të plotë me objektivat e Programit Politik të Këshillit të Ministrave, i cili synon zhvillimin e industrive kreative si sektorë me potencial të lartë ekonomik dhe kulturor, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë së Shqipërisë në tregun rajonal dhe ndërkombëtar. Në këtë kuadër, projektligji kontribuon drejtpërdrejt në forcimin e politikave për promovimin e kulturës dhe identitetit kombëtar, duke krijuar mekanizma të qëndrueshëm për mbështetjen e krijimtarisë audiovizuale, nxitjen e investimeve dhe përfshirjen e sektorit privat. Gjithashtu, ai reflekton angazhimet e qeverisë për modernizimin e administratës publike dhe

përmirësimin e klimës së biznesit, nëpërmjet krijimit të një strukture institucionale më efikase dhe transparente, si dhe përmes integritit të instrumenteve inovative financiare, në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare.

Në raport me dokumentet strategjike, projektligji përbën një ndërhyrje të planifikuar dhe të domosdoshme për përditësimin e kuadrit ligjor në fushën e audiovizualit, duke reflektuar prioritetet sektoriale të përcaktuara në dokumentet kombëtare të zhvillimit dhe në procesin e integritit evropian. Ai harmonizohet me politikat për zhvillimin e industrive kreative, digjitalizimin e ekonomisë dhe mbështetjen e inovacionit, si dhe me objektivat për rritjen e eksportit kulturor dhe tërheqjen e investimeve të huaja.

Projektakti është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026, me propozim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit.

### **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Projektligji “*Për kinematografinë dhe audiovizualin*” përfaqëson një ndërhyrje të domosdoshme dhe të justifikuar në kuadrin ligjor ekzistues, duke synuar modernizimin e rregullimit të këtij sektori në përputhje me zhvillimet bashkëkohore teknologjike, ekonomike dhe institucionale. Ligji aktual për kinematografinë, i miratuar në një kontekst të ndryshëm historik dhe zhvillimor, është i orientuar kryesisht drejt prodhimit filmik tradicional dhe funksionimit të një strukture të centralizuar si Qendra Kombëtare e Kinematografisë, ndërkohë që projektligji i ri ndërton një model të zgjeruar që përfshin të gjithë sektorin audiovizual, duke integruar instrumente moderne të zhvillimit të industrive kreative. Përmes këtij riformulimi konceptual dhe institucional, krijohet një qasje bashkëkohore, koherente dhe tërësisht e harmonizuar me praktikën më të avancuar evropiane, duke e orientuar sektorin drejt zhvillimit të qëndrueshëm, konkurrencës ndërkombëtare dhe inovacionit kulturor.

Në këtë kuadër, një nga përparësitë kryesore të projektligjit qëndron në rikonceptimin e modelit institucional përmes krijimit të Agjencisë Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA), e konceptuar si një strukturë moderne, e integruar dhe plotësisht e harmonizuar me modelet e konsoliduara evropiane. Ky transformim institucional nuk përfaqëson thjesht një ndryshim emërtimi ose riorganizim administrativ, por shënon kalimin drejt një paradigme

të re qeverisjeje, e cila mbështetet në profesionalizëm, kolegjalitet vendimmarrës, transparencë dhe orientim strategjik.

Në shtete të Bashkimit European, si Franca, funksionon një institucion i specializuar si Centre National du Cinéma et de l'image animée (CNC), i cili ushtron funksione të gjera që shkojnë përtej financimit të projekteve, duke përfshirë rregullimin e tregut, mbështetjen automatike dhe selektive, si dhe administrimin e fondeve të dedikuara për industrinë audiovizuale. Po kështu, në Itali operon Direzione Generale Cinema e Audiovisivo, një strukturë brenda Ministrisë së Kulturës që bashkërendon politikat publike për sektorin dhe menaxhon skema të avancuara financimi dhe incentivash fiskale. Këto modele tregojnë një tendencë të qartë në nivel europian drejt institucioneve me rol aktiv zhvillimor dhe jo thjesht administrativ, model të cilin projektligji shqiptar synon ta adoptojë përmes AKKA-së. Duke ndjekur këto modele dhe praktikat e institucioneve homologe në Kroaci, Belgjikë dhe Luksemburg, AKKA projektohet si një strukturë publike me rol aktiv në zhvillimin e industrisë, duke kombinuar funksionet e politikëbërjes, zbatimit, rregullimit dhe mbështetjes financiare në një model të vetëm të koherent, profesional dhe të parashikueshëm. Në këtë mënyrë, projektligji vendos themelet për një institucion që jo vetëm administron mekanizmat e mbështetjes, por edhe orienton zhvillimin e sektorit, analizon ecurinë e tregut, nxit bashkëprodhimet, forcon kapacitetet profesionale dhe garanton përputhje me standardet dhe praktikat e Bashkimit European.

Një tjetër përparësi e rëndësishme e projektligjit lidhet me integrimin e instrumenteve fiskale dhe financiare për mbështetjen e sektorit në praktikat e Bashkimit European, të cilat përbëjnë sot një nga mekanizmat më efektivë për zhvillimin dhe ndërkombëtarizimin e industrisë audiovizuale.. Në juridiksione të konsoliduara të Bashkimit European, si Franca dhe Italia, skema e rimbursimit të shpenzimeve të prodhimit (cash rebate) kanë rezultuar instrumente kyçe për tërheqjen e investimeve vendase dhe të huaja, si dhe për rritjen e kapaciteteve konkurruese të sektorit. Për shembull, në Itali, kredia tatimore për prodhimet audiovizuale mund të arrijë deri në 40% (dyzet përqind) të shpenzimeve të pranueshme, ndërsa në Hungari një nga modelet më të suksesshme në Europë, skema e rimbursimit arrin rreth 30% (tridhjetë) të shpenzimeve të kryera në territor. Në Kroaci, gjithashtu, funksionon një sistem i ngjashëm që ka bërë vendin një destinacion të rëndësishëm për prodhimet ndërkombëtare. Këto mekanizma nuk kanë thjesht funksion stimulues financiar, por përbëjnë në vetvete arkitekturën ekonomike mbi të cilën mbështetet zhvillimi modern i industrisë audiovizuale në

Europë. Modele si ato franceze dhe italiane demonstrojnë se kombinimi i skemave të mbështetjes automatike, stimujve fiskalë dhe fondeve të dedikuara krijon një mjedis të parashikueshëm, tërheqës dhe të qëndrueshëm për prodhimin filmik dhe audiovizual, duke prodhuar efekte pozitive si në dimensionin kulturor, ashtu edhe në atë ekonomik.

Projektligji shqiptar, duke adoptuar këto mekanizma, e pozicionon industrinë vendase brenda paradigmës bashkëkohore të politikave të mbështetjes së sektorit dhe siguron një kuadër konkurrues në nivel rajonal dhe europian.

Projektligji gjithashtu përputhet me praktikat europiane në drejtim të planifikimit strategjik dhe zhvillimit të politikave sektoriale. Në shumë vende të BE-së, politikat publike për industrinë audiovizuale mbështeten në dokumente strategjike shumëvjeçare, të cilat përcaktojnë prioritetet të qarta, alokime buxhetore afatgjata dhe instrumente të mirëstrukturuara të mbështetjes. Në këtë drejtim, parashikimi i Programit Kombëtar për Zhvillimin e Krijimtarisë Kinematografike dhe Audiovizuale përfaqëson një përparësi të dukshme të projektligjit, pasi krijon bazën institucionale dhe strategjike për një qasje të koordinuar, të qëndrueshme dhe të parashikueshme ndaj sektorit Ky program i jep industrisë një horizont planifikimi afatmesëm dhe afatgjatë, duke shmangur fragmentarizimin e politikave, vendimmarrjen ad hoc dhe varësinë nga ciklet periodike institucionale. Përmes këtij mekanizmi, projektligji siguron një unifikim të politikave të mbështetjes, një rritje të profesionalizmit në hartimin e tyre dhe një orientim të qartë drejt objektivave zhvillimore në përputhje me standardet europiane dhe me nevojat strukturale të industrisë audiovizuale në Shqipëri.

Në aspektin e efekteve të pritshme, përvoja ndërkombëtare dëshmon se miratimi i një kuadri ligjor modern, i shoqëruar me instrumente financiare efektive dhe me institucione funksionale, gjeneron ndikime të menjëhershme dhe të qëndrueshme në zhvillimin e industrisë audiovizuale. Vende si Hungaria, Kroacia dhe Malta kanë arritur të pozicionohen si destinacione të rëndësishme për prodhimet ndërkombëtare falë skemave konkurruese të rimbursimit, stabilitetit rregullator dhe politikave proaktive të mbështetjes shtetërore. Këto vende kanë njohur përfitime të konsiderueshme si rezultat i rritjes së volumit të prodhimeve të realizuara në territorin e tyre, injektimit të kapitalit të huaj në ekonomi dhe krijimit të vendeve të reja të punës në sektorët mbështetës. Ky zhvillim ilustron qartë efektet shumëfishta që gjenerohen nga politika të modeluara në mënyrë

koherente, të parashikueshme dhe të mirëorientuara. Në këtë drejtim, projektligji shqiptar ka potencialin të prodhojë efekte të ngjashme, duke e pozicionuar Shqipërinë si një destinacion konkurrues në rajon për prodhimet filmike dhe audiovizuale. Kombinimi i instrumenteve fiskale, rritja e kapaciteteve institucionale përmes AKKA-së, e cila në përbërjen e saj ka integruar Komisionin Shqiptar të Filmit dhe krijimi i një mjedisi rregullator të parashikueshëm mundëson jo vetëm tërheqjen e projekteve ndërkombëtare, por edhe konsolidimin e industrisë vendase, rritjen e profesionalizmit dhe zhvillimin e zinxhirit të vlerës së industrive krijuese në tërësi.

Parashikimet e projektligjit “Për kinematografinë dhe audiovizualin”, veçanërisht ato që lidhen me krijimin e një arkitekture të avancuar incentivash fiskale, me skemat e rimbursimit të shpenzimeve të prodhimit dhe ngritjen e një strukture të specializua institucionale si AKKA, kanë potencialin të ndikojnë drejtpërdrejt në pozicionimin e Shqipërisë si një destinacion konkurrues për prodhimet kinematografike dhe audiovizuale ndërkombëtare.

Në industrinë globale të filmit, zgjedhja e një vendi për realizimin e xhirimeve nuk bazohet vetëm në faktorë artistikë apo natyrorë, por nga një vlerësim i gjithanshëm i elementeve ekonomike, financiare dhe institucionale. Vendimmarrja e prodhuesve ndërkombëtarë mbështetet zakonisht në një analizë të kombinuar të kostove të prodhimit, ekzistencës së skemave konkurruese të incentivave fiskale, lehtësisë dhe efikasitetit të procedurave administrative dhe stabilitetit institucional të vendit pritës. Në këtë kontekst, projektligji synon të adresojë disa nga këta faktorë determinantë, duke ndërtuar një kuadër të parashikueshëm, transparent dhe të harmonizuar me praktikën e suksesshme të vendeve të rajonit dhe të Bashkimit Europian, të cilat kanë arritur të tërheqin me sukses prodhime të rëndësishme ndërkombëtare përmes incentivave fiskale, strukturave të specializuara dhe një ekosistemi të favorshëm institucional. Kështu, Shqipëria, qaset të pozicionohet për të konkurruar në mënyrë më efektive në tregun global të shërbimeve prodhuese filmike dhe audiovizuale.

Në rajonin e Ballkanit, vendet që kanë arritur të pozicionohen si destinacione tërheqëse për industrinë audiovizuale kanë ndërtuar politika të qarta dhe konkurruese incentivash, duke krijuar një ekosistem të favorshëm për prodhimet ndërkombëtare. Për shembull, Kroacia dhe Serbia ofrojnë skema rimbursimi (cash rebate) që variojnë nga 25% deri në 30% të shpenzimeve të pranueshme në

territorin e tyre, ndërsa Hungaria, edhe pse jashtë Ballkanit të ngushtë, përbën një benchmark rajonal me një skemë rimbursimi prej rreth 30%, e shoqëruar me procedura të thjeshtuara dhe një administrim shumë efikas përmes një strukture të dedikuar (National Film Office). Ky kombinim i incentivave fiskale konkurruese dhe administrimit profesional ka pozicionuar Hungarinë si një nga destinacionet më të kërkuara për prodhimet ndërkombëtare në Europë. Po ashtu, Maqedonia e Veriut ka aplikuar një politikë konkurruese incentivash, duke ofruar deri në 30% rimbursim, çka ka bërë të mundur tërheqjen e një numri të konsiderueshëm prodhimesh ndërkombëtare në vitet e fundit. Në kontekstin e krahasimeve me këto vende, Shqipëria deri më tani ka qenë në një pozicion më pak konkurrues, kryesisht për shkak të mungesës së një kuadri të qartë ligjor dhe financiar që të ofrojë siguri dhe avantazh ekonomik për producentët e huaj. Mungesa e instrumenteve moderne të incentivimit ka kufizuar potencialin e vendit për të konkurruar në mënyrë të barabartë me fqinjët e tij, pavarësisht kapaciteteve natyrore, logjistike dhe artistike që Shqipëria disponon.

Në këtë drejtim, integrimi në projektligj i mekanizmit si rimbursimi i shpenzimeve përbën një ndryshim thelbësor, e cila ka potencialin të reduktojë ndjeshëm hendekun konkurrues midis Shqipërisë dhe vendeve të rajonit që tashmë zbatojnë politika të konsoliduara incentivash. Nëse këto instrumente do të strukturohen në mënyrë të qartë dhe të zbatohen në praktikë me efikasitet, ato mund të bëjnë që Shqipëria të ofrojë një kombinim tërheqës të kostove relativisht të ulëta të prodhimit, incentivave financiare dhe diversitetit natyror e kulturor që vendi ofron. Ky kombinim është veçanërisht e rëndësishme për prodhimet me buxhet të mesëm dhe të madh, të cilat zakonisht zhvillojnë një analizë të detajuar krahasuese midis vendeve përpara se të marrin vendimin përfundimtar të vendosjes së prodhimit. Projektligji, përmes këtyre mekanizmave, synon t'i mundësojë Shqipërisë një pozicionim më të fortë në këtë proces konkurrues ndërkombëtar.

Megjithatë, përvoja e vendeve të rajonit tregon se incentivat financiare, ndonëse përbëjnë një komponent thelbësor të paketës së mbështetjes, nuk janë të mjaftueshme në vetvete për të garantuar tërheqjen e qëndrueshme të prodhimeve ndërkombëtare. Një faktor po aq vendimtar është ekzistenca e një strukture funksionale dhe të specializuar, e cila vepron si pikë e vetme kontakti për producentët dhe kompanitë e prodhimit, duke lehtësuar procedurat administrative, koordinimin me institucionet shtetërore dhe sigurimin në kohë të

lejeve dhe autorizimeve të nevojshme. Në shumë vende europiane dhe rajonale, ky rol ushtrohet nga struktura të tipit “Film Commission”, e cila ka dëshmuar se është instrument kyç për thjeshtimin e barrierave administrative, rritjen e atraktivitetit të territorit dhe forcimin e kapacitetit konkurrues të vendeve pritëse. Agjencia Kombëtare e Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA) nëpërmjet Komisionit Shqiptar të Filmit (Albanian Film Commission) do të administrojë procesin e rimbursimit të shpenzimeve dhe do të garantojë koherencë, efikasitet dhe transparencë në zbatimin e skemave të mbështetjes financiare. AKKA do të ushtrojë funksionet e pikes së vetme të kontaktit, duke ofruar shërbime të specializuara për producentët, duke lehtësuar marrëdhëniet me institucionet publike dhe duke promovuar Shqipërinë si destinacion filmik.

Një tjetër element që ndikon në zgjedhjen e një vendi për realizimin e xhirimeve lidhet me sigurinë juridike dhe stabilitetin e kuadrit rregullator. Vendet e rajonit që kanë arritur të tërheqin prodhime të mëdha ndërkombëtare kanë ndërtuar sisteme të qëndrueshme, të parashikueshme, dhe të bazuara në procedura të qarta ku, afatet, kriteret e përfitimit dhe mekanizmat e zbatimit janë të standardizuara dhe të garantuara. Në këtë aspekt, projektligji shqiptar përbën një hap pozitiv, pasi krijon një bazë ligjore më të qartë dhe më të strukturuar për funksionimin e sektorit kinematografik dhe audiovizual. Megjithatë, paqartësitë e identifikuar në lidhje me ndarjen e kompetencave ndërmjet institucioneve që bëjnë pjesë në këtë ekosistem, statusin e disa subjekteve ekzistuese dhe mënyrën e zbatimit të instrumenteve financiare mund të ndikojnë në prodhimin e efekteve të pritshme të reformës. Në aspektin krahasues, Shqipëria zotëron disa avantazhe natyrore dhe ekonomike që mund të shfrytëzohen në mënyrë strategjike për të pozicionuar vendin si një destinacion tërheqës për prodhimet filmike dhe audiovizuale. Diversiteti i peizazheve, nga bregdeti, zonat alpine dhe qytetet historike deri te hapësirat urbane bashkëkohore krijon një gamë të gjerë lokacionesh filmike brenda një territori kompakt, kostoja relativisht e ulët e fuqisë punëtore, kombinimi me kostot konkurruese të shërbimeve lokale dhe mungesa e mbingarkesës së tregut, në raport me destinacionet më të konsoliduara, përbëjnë elementë që mund të kthehen në avantazhe të spikatura konkurruese. Megjithatë, deri më tani, këto potenciale nuk janë përkthyer në një fluks të qëndrueshëm prodhimesh ndërkombëtare për shkak të mungesës së një kuadri të integruar politikash, të harmonizuar me standardet ndërkombëtare, i cili të kombinojë instrumentet fiskale, procedurat e thjeshtuara, strukturat institucionale të specializuara dhe qartësinë rregullatore. Pa një arkitekturë të tillë koherente,

avantazhet natyrore dhe ekonomike nuk mjaftojnë për të ndërtuar një ekosistem të qëndrueshëm dhe konkurrues të shërbimeve prodhuese. Projektligji synon pikërisht të adresojë këtë boshllëk, duke krijuar bazat për një model zhvillimi që i transformon këto asetet ekzistuese në përparësi të prekshme për industrinë dhe në faktorë të qëndrueshëm tërheqjeje për prodhimet ndërkombëtare.

Parashikimet e projektligjit pritet të gjenerojnë ndikime të drejtpërdrejta edhe në rritjen dhe forcimin e ndërgjegjësimit për kulturën shqiptare, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar. Industria audiovizuale përbën një nga mjetet më të fuqishme dhe efektive të komunikimit dhe diplomacisë kulturore, pasi përmes narrativës filmike, gjuhës artistike dhe imazhit vizual transmeton në mënyrë organike elemente të identitetit kombëtar, historisë, traditave dhe mënyrës së jetesës së një vendi në një audiencë shumë më të gjerë sesa format tradicionale të promovimit kulturor. Kjo e bën sektorin një vektor të rëndësishëm të difuzionit kulturor dhe gjuhësor, duke i mundësuar kulturës shqiptare të depërtojë në hapësira të reja gjeografike, përtej kufijve të formave tradicionale të promovimit. Filmi dhe prodhimet audiovizuale kanë aftësinë të krijojnë lidhje emocionale dhe njohëse me audiencat ndërkombëtare, të gjenerojnë kuriozitet dhe të nxisin interesa të reja kulturore, gjuhësore dhe turistike. Përmes zgjerimit të prodhimeve, mbështetjes së shtuar për prodhimet vendase, rritjes së cilësisë artistike, bashkëprodhimeve ndërkombëtare dhe shpërndarjes në platforma globale, projektligji kontribuon drejtpërdrejt në amplifikimin e pranisë së kulturës dhe gjuhës shqipe në mozaikun kulturor evropian dhe botëror.

Kështu, industria audiovizuale shndërrohet jo vetëm në një sektor ekonomik dhe kreativ, por edhe në një mekanizëm të qëndrueshëm të difuzionit kulturor, duke forcuar imazhin e Shqipërisë në arenën ndërkombëtare dhe duke rritur vlerën e saj të perceptuar si një vend me identitet të pasur, narrativë origjinale dhe potencial të lartë krijues.

Për më tepër, mekanizmat e parashikuar për promovimin dhe shpërndarjen e veprave audiovizuale rrisin mundësinë që produkti kulturor shqiptar të jetë i pranishëm në festivale, tregje ndërkombëtare dhe platforma globale, duke e bërë kulturën shqiptare më të dukshme dhe më të aksesueshme. Këto mekanizma krijojnë një infrastrukturë të qëndrueshme për qarkullimin ndërkombëtar të përmbajtjes, duke e bërë kulturën shqiptare më të dukshme, më të aksesueshme dhe më të integruar në ekosistemin global të industrive kreative. Në këtë mënyrë, rritet jo vetëm prania e veprave shqiptare në hapësirat kulturore ndërkombëtare,

por forcohet edhe aftësia e tyre për të kontribuar në difuzionin e kulturës, narrativës dhe gjuhës shqipe në një publik më të gjerë dhe më të larmishëm. Njëkohësisht, përvoja ndërkombëtare tregon se zhvillimi i industrisë audiovizuale lidhet ngushtë me rritjen e aktivitetit turistik, përmes fenomenit të njohur si *“film-induced tourism”*. Vende të ndryshme kanë përfituar ndjeshëm nga ekspozimi që fitojnë përmes prodhimeve kinematografike dhe audiovizuale, duke tërhequr vizitorë që kërkojnë të eksplorojnë vendndodhjet ku janë realizuar filmat apo serialet e njohura. Ky lloj turizmi, i nxitur nga fuqia e narrativës dhe imazhit filmik, ka rezultuar një instrument efektiv për promovimin e territorit, rritjen e interesit ndërkombëtar dhe gjenerimin e të ardhurave të qëndrueshme për ekonominë vendase. Në këtë drejtim, parashikimet e projektligjit që synojnë tërheqjen e prodhimeve të huaja në territorin shqiptar, nëpërmjet incentivave financiare konkurruese dhe lehtësimit të procedurave administrative, krijojnë mundësinë që Shqipëria të integrohet në mënyrë të natyrshme në këtë dinamikë pozitive të industrisë globale. Këto ndërhyrje rrisin aftësinë e vendit për të përfituar nga efekti shumëpërshkues i prodhimeve ndërkombëtare, duke gjeneruar jo vetëm vlerë ekonomike, por edhe ekspozim kulturor dhe promovim territorial. Duke kombinuar instrumentet fiskale me procedura të unifikuara dhe institucione të specializuara, projektligji synon të krijojë një mjedis të besueshëm, funksional dhe të parashikueshëm, i cili i mundëson Shqipërisë të konkurrojë në mënyrë të barabartë me vendet e rajonit dhe të Bashkimit Europian që tashmë kanë përfituar nga *“film-induced tourism”* dhe nga prania e produkteve audiovizuale të nivelit të lartë.

Duke qenë se Shqipëria disponon një diversitet të jashtëzakonshëm natyror dhe kulturor, nga bregdeti mesdhetar deri te qytetet historike, peizazhet malore dhe hapësirat urbane në zhvillim, Shqipëria disponon një gamë të jashtëzakonshme lokacionesh filmike që e pozicionojnë vendin si një territor me potencial të lartë vizual dhe narrativ. Ky diversitet i peizazheve, i kombinuar me fleksibilitetin klimatik dhe afërsinë gjeografike midis vendeve të ndryshme të xhirimit, krijojnë një mjedis jashtëzakonisht të përshtatshëm për prodhimet filmike dhe audiovizuale të të gjitha zhanreve.

Rritja e numrit të prodhimeve të realizuara në territorin shqiptar gjeneron jo vetëm përfitime të drejtpërdrejta ekonomike gjatë fazës së xhirimeve, si rritje e kërkesës për punësim lokal, shërbime teknike, akomodimi, transporti dhe logjistike, por prodhon gjithashtu një efekt shumëplanësh afatgjatë në ekonomi dhe imazh kombëtar. Ky efekt shtrihet në rritjen e fluksit turistik përmes fenomenit të njohur

“film-induced tourism”, ku audiencat ndërkombëtare, të ekspozuara ndaj peizazheve dhe lokacioneve filmike, zhvillojnë interes për t'i vizituar ato fizikisht. Si rezultat, prodhimet audiovizuale funksionojnë si një formë e fuqishme e promovimit indirekt të vendit, duke forcuar pozicionimin e tij si destinacion kulturor, natyror dhe turistik.

Kështu, industria audiovizuale shndërrohet në një instrument të qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik dhe diplomacisë kulturore, duke kontribuar në rritjen e vizibilitetit ndërkombëtar të Shqipërisë dhe në afirmimin e saj si një vend me identitet të spikatur kulturor dhe potencial të lartë krijues.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR**

Ky projektvendim është bazuar në nenin 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës të Kushtetutës.

#### **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)**

Projektvendimi nuk synon përafrimin me legjislacionin e BE.

#### **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT**

Projektvendimi është i përbërë nga VII krerë, 39 nene, të cilët ndërtojnë një arkitekturë të re ligjore të sektorit, të bazuar në parime moderne, koherente dhe të integruara.

##### **KREU I — DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Ky kre përcakton objektin, fushën e zbatimit dhe përkufizimet themelore që rregullojnë terminologjinë ligjore të sektorit. Ai zgjeron ndjeshëm fushën e rregullimit, duke kaluar nga një fokus i kufizuar në kinematografi drejt një qasjeje gjithëpërfshirëse mbi industrinë audiovizuale, duke përfshirë veprat filmike, serialet, platformat digjitale, videolojërat dhe format e tjera bashkëkohore të krijimtarisë. Për herë të parë, parashikohen instrumente fiskale si e rimbursimi i shpenzimeve (cash rebate).

## KREU II — AGJENCIA KOMBËTARE E KINEMATOGRAFISË DHE AUDIOVIZUALIT (AKKA)

Ky kre rregullon krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA), si institucioni qendror publik me mandat të zgjeruar për zhvillimin, mbështetjen dhe promovimin e sektorit. Ai përcakton statusin juridik, parimet e funksionimit, kompetencat strategjike dhe administrative, burimet e financimit, si dhe strukturën organizative dhe organet drejtuese, përfshirë Këshillin Drejtues dhe Drejtorin e Përgjithshëm. Gjithashtu, rregullohen rolet e strukturave mbështetëse si Këshilli Artistik, Komisioni i Vizionimit dhe Komisioni Financiar. Ky kapitull vendos themelet e një modeli të ri qeverisjeje institucionale, të bazuar në transparencë, kolegjalitet dhe profesionalizëm.

## KREU III — KOMISIONI SHQIPTAR I FILMIT

Kreu III parashikon krijimin e Komisionit Shqiptar të Filmit (Albanian Film Commission) si një strukturë brenda AKKA, me funksione promovuese, operacionale dhe koordinuese. AKKA nëpërmjet Komisionit Shqiptar të Filmit vepron si pikë e vetme kontakti për prodhimet audiovizuale, mbështet procesin e pajisjes me leje, koordinon bashkëpunimin me pushtetin vendor, promovon Shqipërinë si destinacion filmik dhe administron fondet përkatëse për shërbime prodhimi dhe incentiva. Ky model është në përputhje me praktikat më të mira evropiane, duke rritur atraktivitetin e vendit për prodhime ndërkombëtare.

## KREU IV — MEKANIZMAT E MBËSHTETJES FINANCIARE DHE INCENTIVAT FISKALE

Ky kre vendos një kornizë të re për mbështetjen financiare dhe fiskale të industrisë audiovizuale. Ai parashikon mbështetjen selektive përmes thirrjeve publike, kategorizimin e projekteve sipas natyrës dhe fazës së zhvillimit, si dhe instrumente të avancuara si skema e rimbursimit të shpenzimeve (cash rebate) deri në 35%. Ky kapitull përbën një nga elementët më inovativë të projektligjit dhe një bazë të rëndësishme për rritjen e konkurrueshmërisë ndërkombëtare të sektorit.

## KREU V — PRODHIMI, SHPËRNDARJA, SHFAQJA DHE REGJISTRI KOMBËTAR

Kreu V rregullon në mënyrë të integruar zinxhirin e prodhimit, shpërndarjes dhe shfaqjes së veprave audiovizuale. Ai përcakton detyrimet e aktorëve të tregut, krijon Regjistrin Kombëtar të Sektorit Kinematografik dhe Audiovizual si një platformë të integruar të dhënash, vendos detyrimin për shfaqjen e premierave të filmave shqiptarë dhe rregullon veprimtarinë e shoqatave profesionale. Ky kuadër kontribuon në formalizimin e tregut dhe në zhvillimin e politikave të bazuara në evidencë.

#### **KREU VI — BASHKËPUNIMI NDËRINSTITUCIONAL**

Ky kre përcakton mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve kryesore të sektorit, përfshirë AKKA-n, Albafilm sh.a., Arkivin Qendror të Filmit dhe Autoritetin e Mediave Audiovizuale. Ai forcon rolin e Albafilm sh.a. si një qendër prodhimi dhe shërbimesh, përcakton detyrimet për administrimin e aseteve filmike dhe garanton koordinimin institucional, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të miturve dhe klasifikimit sipas moshës.

#### **KREU VII — DISPOZITA TRANZITORE DHE PËRFUNDIMTARE**

Kreu përmbyllës parashikon masat për tranzicionin institucional, përfshirë transferimin e funksioneve nga QKK në AKKA brenda një periudhe 6-mujore, kalimin e burimeve njerëzore dhe aseteve, si dhe afatet për miratimin e akteve nënligjore. Gjithashtu, ai përcakton shfuqizimin e ligjit ekzistues për kinematografinë, duke garantuar një kalim të qetë drejt kuadrit të ri ligjor.

### **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT**

Për zbatimin e këtij akti ngarkohen ministria përgjegjëse për kulturën, QKK, AKKA, AQSHF dhe ALBAFILM SH.A.

### **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT**

Projektligji është hartuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, dhe Sportit dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë dhe është dërguar për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Ekonomisë dhe

Inovacionit, Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE**

Projektligji “Për kinematografinë dhe audiovizualin” parashikon krijimin e një strukture të re institucionale funksionale (AKKA), zgjerimin e instrumenteve të mbështetjes financiare dhe futjen e mekanizmave fiskalë incentivues për industrinë audiovizuale.

Në aspektin e shpenzimeve buxhetore, projektligji nuk krijon në thelb një institucion tërësisht të ri nga pikëpamja financiare, pasi Agjencia Kombëtare e Kinematografisë dhe Audiovizualit (AKKA) ndërtohet mbi bazën e transformimit të strukturës ekzistuese të Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, dhe një pjesë e konsiderueshme e burimeve njerëzore, infrastrukurore dhe financiare do të transferohen nga institucioni ekzistues, duke kufizuar nevojën për rritje të menjëhershme të shpenzimeve operative. Megjithatë, zgjerimi i funksioneve të AKKA-së, sidomos në drejtim të administrimit të programeve zhvillimore, menaxhimit të skemave të reja financiare dhe rolit të saj në promovimin ndërkombëtar, do të kërkojë rritje graduale të kapaciteteve administrative dhe teknike, çka pritet të reflektohet në një shtesë të moderuar të shpenzimeve në afatmesëm.

Një komponent i rëndësishëm i shpenzimeve lidhet me fondet publike për mbështetjen e prodhimeve audiovizuale. Projektligji ruan dhe zgjeron logjikën e financimit përmes buxhetit të shtetit, duke parashikuar skema të ndryshme mbështetjeje, përfshirë grantet, bashkëfinancimin dhe instrumente të tjera zhvillimore. Në këtë kuadër, ndikimi buxhetor do të varet nga niveli i fondeve që do të përcaktohen çdo vit në ligjin e buxhetit, por gjithsesi pritet që orientimi i politikave publike drejt industrive kreative të kërkojë një rritje progresive të këtyre fondeve, në përputhje me objektivat strategjike të zhvillimit të sektorit.

Një element me ndikim të drejtpërdrejtë fiskal është parashikimi i mekanizmave incentivues, si rimbursimi i shpenzimeve (cash rebate) për prodhimet audiovizuale. Ky mekanizëm, në afat të shkurtër, mund të përbëjë një kosto për buxhetin e shtetit, pasi reduktojnë të ardhurat tatimore ose krijojnë detyrime për pagesa nga buxheti në formën e rimbursimeve. Megjithatë, përvoja ndërkombëtare tregon se këto instrumente kanë një efekt neto pozitiv në afatmesëm dhe afatgjatë, pasi gjenerojnë aktivitet ekonomik shtesë, rrisin bazën

tatimore dhe kontribuojnë në formalizimin e sektorit. Në këtë drejtim, ndikimi fiskal i këtyre skemave duhet të vlerësohet jo vetëm në termat e kostos direkte, por edhe në raport me të ardhurat indirekte që gjenerohen nga shpenzimet e prodhimeve të huaja dhe vendase në territorin e Republikës së Shqipërisë. Nga ana e të ardhurave, projektligji krijon potencial për rritje të të ardhurave publike përmes disa kanaleve. Së pari, zhvillimi i industrisë audiovizuale dhe rritja e prodhimeve në vend pritet të gjenerojnë të ardhura nga tatimi mbi fitimin, tatimi mbi të ardhurat personale dhe kontributet shoqërore, si rezultat i rritjes së punësimit dhe aktivitetit ekonomik në sektorët e lidhur. Së dyti, shpenzimet e prodhimeve ndërkombëtare në territorin shqiptar (akomodim, transport, shërbime teknike, punësim lokal) krijojnë një efekt shumëfishues në ekonomi, duke kontribuar në rritjen e të ardhurave tatimore dhe në zhvillimin e sektorëve mbështetës, si turizmi dhe shërbimet. Së treti, formalizimi i operatorëve të sektorit filmik dhe audiovizual përmes regjistrave dhe mekanizmave të rinj rregullatorë pritet të përmirësojë mbledhjen e të ardhurave dhe të reduktojë informalitetin në sektor.

Në vlerësimin e përgjithshëm, projektligji paraqet një raport të balancuar ndërmjet kostove buxhetore dhe përfitimeve ekonomike të pritshme. Ndonëse në afat të shkurtër mund të kërkohet një angazhim shtesë financiar nga buxheti i shtetit, në afatmesëm dhe afatgjatë ai pritet të kontribuojë në zgjerimin e bazës ekonomike dhe tatimore, si dhe në rritjen e konkurrueshmërisë së vendit në sektorin kinematografik dhe audiovizual.

**MINISTRI**  
**Blendi GONXHJA**